



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLICA KOSOVA  
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT  
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 38584  
U. 2 Br. 18712

REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLICA KOSOVA  
Br. str. KOMUNA E KAMENICËS  
OPŠTINE KAMENICË KAMENICË MUNICIPALITY OF KAMENICA



Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 70 të Statutit Sh.01.nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, nxjerr këtë:

## V E N D I M PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E KAMENICËS

1. Me këtë Vendim synohet thjeshtimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Kamenicës.
2. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër të komunës janë të paraqitura në Shtojcën 1 të këtij Vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohen nga data 01 janar 2025.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjithë drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet, sipas Shtojcës 1;
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Zyrës së Kryeministrit.



**Shtojca 1: Shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Kamenicës**

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTAVE QË NUK KËRKOHEN MË PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
<b>DREJTORIA PËR PRONË, KADASTËR DHE GJEODEZI</b>		
1.	Çertifikata e pronës	1. Ekstrakti i lindjes vetëm për palët me shtetësi të Republikës së Kosovës
2.	Procedura për parcelizim dhe bashkim	1. Letërinformata për pronën nëse është zonë rurale apo urbane
3.	Procedura për bashkim	1. Letërinformata për pronën nëse është zonë rurale apo urbane
4.	Kopja e planit	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë 2. Letërnjoftimi 3. Çertifikata e biznesit për persona juridik
<b>DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM HAPËSINOR</b>		
5.	Leja ndërtimore	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë
<b>DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL</b>		
6.	Numri i NIF	1. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë
7.	Leje për prerje të drunjëve në pyje publike dhe private	Nuk do të ofrohet më si shërbim
<b>DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, AMBIENT, INSPEKTORAT DHE EMERGJENCA</b>		
8.	Leja për taxi	1. Vërtetimi nga gjykata 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave 3. Çertifikata e vendbanimit
9.	Vazhdimi i lejes për taxi	1. Leja për ushtrimin e vëprimtarisë për taxi 2. Vërtetimi i pagesës së mbeturinave 3. Vërtetimi i pagesës së tatimit në pronë

**DREJTORIA PËR MIRËQENIE SOCIALE DHE SHËNDETËSI**

10.	Ri-aplikimi për palët që janë shfrytëzues të asistencës sociale dhe që arrijnë moshën e pensionistit	1. Vendimi i statusit të pensionistit të moshës
-----	--	---

**DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET**

11.	Vërtetim mbi bilancin e pagesave të taksave	1. Kopja e letërnjoftimit
-----	---	---------------------------